

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. BLERIM TOMINAJ

06/16/2020

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 12.6.2020 për subjektin e rivlerësimit, Blerim Tominaj, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, në datën 16.6.2020, vendosi: Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Blerim Tominaj, prokuror në Prokurorinë e Krimeve të Rënda.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Genta Tafa Bungo, znj. Suela Zhegu relatores, znj. Etleda Çiftja anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe / ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.